



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljena / Podato Received / Delivered	28 - 06 - 2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednoca Org / Unit	SKOMSHK 3321/2021	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
			114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.432/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca - kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabanianëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2423/19 të datës 17.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar Ankesën A.nr.344/2019, të datës 19.06.2019 të parashtruar nga ankuesi nga Komuna e Kaçanikut, kundër organit të punësimit/Komuna e Kaçanikut, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.06.2021, mori këtë;

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.344/2019, e datës 19.06.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.01-104/02-1497/2019, i datës 31.05.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Kaçanikut.

A r s y e t i m

Komuna e Kaçanikut, me datë 16.04.2019, ka shpallur konkurs për plotësimin e pozitës "Zyrtar për Ndërtimtari". Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi mirëpo i njëjti nuk është përfshi në listën e ngushtë nga Komisioni Përzgjedhës.

Ankuesi i pakënaqur me mos përfshirjen e tij në listën e ngushtë, me datë 17.05.2019, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Kaçanikut. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 31.05.2019, përmes Vendimit me numër protokolli Nr.01-104/02-1497/2019 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Kundër Vendimit me numër protokollit Nr.01-104/02-1497/2019 të datës 31.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ankuesi, me datë 16.06.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 27/82 të regjistruar me numër A.nr.344/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale dhe materiale, dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Në mungesë të kuorumit për vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi të njëjtën kohë ka hapur edhe konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 17.05.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.2423/2019, përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtojë dhe të vendos për ankesën e datës 19.06.2019 të parashtruar nga ankuesit

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2782/2019 e datës 19.06.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës: Ankesa A. Nr. 432/2021, të datës 21.05.2021, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Vendimin me Nr.01-104/02-14797/2019 i datës 31.05.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Kaçanikut: Emalin e datës 13.05.2019 drejtuar ankuesit nga ana e Komunës së Kaçanikut: Emali i datës 14.05.2019 drejtuar Komunës nga ana e Ankuesit: Vendimin e datës 30.08.2016 i Ministres së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë: Certifikata e Regjistrimit të Biznesit me numër të biznesit 71079589 e datës së regjistrimit 31.07.2014: Përgjigja në ankesë e datës 05.07.2019: Flete dorëzimi i datës 31.05.2019: Emali i datës 20.05.2019: Ankesa e datës 17.05.2019 me numër të protokollit 01-104/02-14797 parashtruar në Komunën e Kaçanikut: Formulari i Aplikimit i kandidatit L.G se bashku me dëshmi mbi përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës: Formulari i Aplikimit i kandidatës M.L se bashku me dëshmi mbi përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës: Formulari i Aplikimit i kandidatit F.E se bashku me dëshmi mbi përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës: Formulari i Aplikimit i kandidatit A.A se bashku me dëshmi mbi përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës: Formulari i Aplikimit i kandidatit A.T se bashku me dëshmi mbi përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës: Formulari i Aplikimit i kandidatit I.B se bashku me dëshmi mbi përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës: Testi me shkrim i mbajtur për të gjithë kandidatet me datë 15.05.2019: Njoftimi i datës 17.05.2019 për kandidatin e suksesshëm: Njoftimi i datës 17.05.2019 me numër të protokollit 01Nr.07-111/01-10028/19 për kandidatet të cilët kanë marrë pjesë në testin përfundimtar lidhur me rezultatin apo pikët e fituara: Vendimi i datës 17.05.2019 me numër të protokollit 01NR.07-111/01-10028/19 për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm për pozitën e punës Zyrtar për Ndërtimtari: Form.MAP-SHCK-11 Raporti final i Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 17.05.2019: Form.MAP-SHCK-10 Rënditja përfundimtare e kandidateve: Form.MAP-SHCK-09 Përmbledhja e Vlerësimeve Individuale: Form.MAP-SHCK-08a; Vlerësimi individual i kandidateve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj: Form.MAP-SHCK-07a Përcaktimi i kriterëve për testin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj: Njoftimi i datës 13.05.2019 me

numër të protokollit 01Nr.07-11/01-10028/19 për kandidatët të cilët janë përzgjedhës për ne listën e ngushtë: Emal-at e datës 13.05.2019; Raporti i datës 10.05.2019 me numër të protokollit 01NR.07-111/01-10028/19 i Komisionit Përzgjedhës i Shërbimit Civil: Form.MAP-SHCK-05 përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë: Form.MAP-SHCK-04 Regjistri i aplikacioneve të pranuar: Deklarate lidhur me nenin 7 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores Nr.02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil: Vendimi i datës 10.05.2019 me numër të protokollit 01Nr.07-11/01-10028/19 mbi Formimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil: Njoftimi për Vazhdimin e Konkursit e datës 02.05.2019: Shpallja e Rekrutimit në gazetën zyrtare datës 16.04.2019: Shpallja e Rekrutimit e datës 16.04.2019: Njoftimi për konfirmimin e mjeteve buxhetore e datës 02.04.2019: Formulari i -PDP përshkrimi i detyrave të punës: Autorizimi i datës 12.04.2019 për procedurën e rekrutimit, nga ana e Ministrisë e Administratës Publike, Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil: Kërkesa për fillimin e rekrutimit e datës 02.04.2019: Njoftimi i datës 03.09.2019, Këshillit Kërkesa për përgjigje në ankese e datës 25.06.2019: Përgjigje në ankesë e datës 05.07.2019.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar sepse:*

Ankuesi pretendon se procedura e rekrutimit nuk është zhvilluar sipas legjislacionit në fuqi, sepse i njëjti nuk është përfshirë në listën e ngushtë edhe pse i ka plotësuar kushtet e konkursit.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, ka analizuar konkursin e shpallur me datë 16.04.2019 për pozitën e punës "Zyrtar për Ndërtimtari" dhe si rrjedhojë ka konstatuar se kriteret e konkursit për këtë pozitë të punës kanë qenë:

- *Diplome Universitare; Fakulteti i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv;*
- *Minimumi dy (2) vite përvojë pune profesionale.*

Përkitazi me këtë, Kolegji ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe duke u bazuar në Vendimin me numër reference 6-1475 të datës 30.08.2016 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka konstatuar se ankuesit i është njohur grada Baccalaureus i ndërtimtarisë - inxhinieri konstruktive të fituar në Universitetin Shtetëror të Tetovës, dhe rrjedhimisht Kolegji vlerëson se ankuesi e ka plotësuar kriterin e konkursit lidhur me kualifikimin. Ndërsa sipas shkresave të lëndës të dorëzuara nga ankuesi dhe organi i punësimit, Kolegji ka gjetur se ankuesi me rastin e aplikimit ka dorëzuar Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit, me numër 71079589 të datës 31.07.2014. Mirëpo i njëjti përveç certifikatës së regjistrimit të biznesit nuk ka sjellë prova tjera të cilat do të vërtetonin faktin se biznesi ka qenë aktiv në periudhën të cilën ankuesi pretendon se e ka përvojën e punës. Në mungesë të këtyre provave, Kolegji vlerëson se ankuesi nuk e ka përmbushur kriterin e konkursit lidhur me përvojën e punës.

Andaj, bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në kuadër të Komunes së Kaçanikut me rastin e përgatitjes së listës së ngushtë ka vepruar në pajtim me dispozitat e Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 28 ku përcaktohet se: 1. *Anëtarët e KPSHC- së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim; 1.1. Arsimi dhe Kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës; 1.3 Shkathhtësia dhe*

aftësitë' dhe 1.4 Elementet tjera te meritës. Rrjedhimisht Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, konstaton se procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 11 paragrafin 1 ku përcaktohet se: Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, po ashtu konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Kaçanikut, me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit dhe nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit Nr.01-104/02-1497/2019 të datës 31.05.2019 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.432/2021

Ruslita Kajtazi

Procesmbajtës

Jeton Koca

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Kaçanikut;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kaçanikut;
- Arkivit të KPMShCK-së

